



Thirrje për aplikim për Trajnimin e Trajnerëve

Tema: “Mobilizimi i burimeve të reja financiare dhe jo-financiare për organizatat e shoqërisë civile”

Qëndrueshmëria financiare e organizatave të shoqërisë civile (OShC) është një ndër sfidat kryesore me të cilat ballafaqohet shoqëria civile në Kosovë, ku përkrahja më e madhe financiare për OShC vjen nga donatorët e huaj dhe fondet publike. Përkrahja si e tillë, e varur kryesisht nga dy burime të vetme të financimit, rrezikon qëndrueshmërinë e shoqërisë civile. Andaj, është e domosdoshme që të hulumtohen edhe mundësitë tjera të financimit dhe diversifikimit të burimeve përfshi forma të tjera të përkrahjes jo-financiare.

Llojllojshmëria e burimeve financiare dhe jo-financiare nënkupton identifikimin dhe mobilizimin e mbështetjes alternative financiare, si dhe kontributin përmes mbështetjes vullnetare nga qytetarët, sektori privat, ekspertët në Kosovë dhe diaspora. Kjo do të mundësonte që OShC-të jenë më të suksesshme në zbatimin e misionit të vet, të fuqizojnë lidhjen me konstituencën, si dhe të rrisin llogaridhënien dhe transparencën në raport me qytetarët.

Me qëllim që të kontribuojë në çështjen e qëndrueshmërisë së burimeve të organizatave të shoqërisë civile, Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF) përmes **Programit për Angazhim Qytetar (CEA)** të cilin e zbaton në partneritet me misionin e USAID në Kosovë, fton të gjithë aktivistët/et e shoqërisë civile të aplikojnë për Trajnimin e Trajnerëve në temën **“Mobilizimi i burimeve të reja financiare dhe jo-financiare për organizatat e shoqërisë civile”**.

Trajnimi mbahet prej **23 deri në 25 shtator 2024** në Prishtinë.

Trajnimi do të ofrohet nga KCSF-së dhe ka për qëllim të transformojë shoqërinë civile në Kosovë duke prezantuar modele për mbledhjen e fondeve nga komuniteti dhe duke ndërtuar lidhje më të forta ndërmjet OShC-ve dhe konstituencës së tyre. Trajnimi mbahet në gjuhë angleze, ndërsa do të ketë përkthim në gjuhën shqipe dhe serbe.

Çka përfitoni nga ky trajnim?

Qëllimi kryesor i këtij trajnimi është zgjerimi i grupit të trajnerëve/trajnerëve profesionistë për diversifikim të burimeve të OShC-ve në përgjithësi, dhe në veçanti modelet e ndryshme të ngritjes së fondeve, që do të siguronte një qëndrueshmëri më të madhe në punën e tyre dhe komunitetet ku veprojnë. Për më tepër, trajnerët pas certifikimit të tyre do të jenë pjesë e një rrjeti më të gjerë të trajnerëve të KCSF-së, dhe do të kenë mundësinë e angazhimit të vazhdueshëm në trajnime të organizuara nga KCSF.

Roli i trajnerëve në këtë proces është të ndihmojë OShC-të që t'i qasen në mënyrë strategjike dhe sistematike temës së mbledhjes së fondeve nga komuniteti, në mënyrë që të sigurohet

mbështetja nga qytetarët, komuniteti dhe bizneset lokale përmes modeleve dhe fushatave të ndryshme të mbledhjes së fondeve. Përmes një kurrikule të dizajnuar enkas për nevojat e OShC-ve në Kosovë, ju do të përfitonit njohuri mbi:

- Hulimtimin dhe identifikimin e burimeve të ndryshme për financimin e punës së OShC apo iniciativave të ndryshme;
- Analizën e modeleve të ndryshme të ngritjes së fondeve, si: ngritja e fondeve përmes dhurimeve, pagesë të anëtarësisë, fushatave të fokusuara individuale për ngritje të fondeve, partneriteteve ndër-sektoriale, kutive të donacioneve, fushatave digjitale, etj.;
- Ndërtimin e partneriteteve me biznese;
- Përgatitjen e fushatave dhe ngjarjeve për të mobilizuar fonde;
- Mjetet dhe format më adekuate për mbledhjen e fondeve nga individët dhe bizneset;
- Mobilizimin e diasporës në ngritje të fondeve;
- Përdorimin e teknologjisë për të mobilizuar fonde;

Kush mund të aplikojë dhe cilat janë kriteret?

Personat me përvojë dhe interesim për organizimin e shoqërisë civile dhe aktivizimin në komunitet rekomandohen fuqimisht të aplikojnë. Përvojat e mëhershme në ngritje të fondeve për shoqëri civile, puna në hartim të fushatave për mbledhje të fondeve konsiderohet si përparësi. KCSF inkurajon gjithpërfshirje nga aspekti gjinor, i etnisë, përfaqësimit gjeografik nga të gjitha rajonet e Kosovës.

Kriteret e aplikimit:

Kandidatët/et për trajnerë/e duhet:

- ✓ Të jenë në dispozicion dhe të përkushtuar për t'u angazhuar si trajnerë/e/ në mentorim të OShC-ve përfituese për mobilizim dhe diversifikim të resurseve të tyre;
- ✓ Të kenë përvojë dhe interesim për zhvillimet e shoqërisë civile dhe aktivizim në komunitet.
- ✓ Të kenë përvojë në mbledhjen e fondeve në komunitet ose fusha të ngjashme sikurse fushatat e grumbullimit të fondeve, promovimi (digjital), komunikimi, planifikimi i biznesit, ndërtimi i kapaciteteve, etj;
- ✓ Të kenë njohuri bazë mbi tendencat e përgjithshme të dhurimeve nga bizneset bashkë me sfidat e OShC-ve për mbledhjen e fondeve;
- ✓ Të kenë përvojë në organizimin dhe mbajtjen e trajnimeve apo programeve të edukimit joformal;
- ✓ Të kenë aftësi të shkëlqyera komunikuese (moderim, komunikim dhe prezantim).
- ✓ Të kenë njohuri të mira të gjuhës angleze;
- ✓ Të kenë diplomë së paku të nivelit bachelor;
- ✓ Të mos jenë të angazhuar në ndonjë parti politike në katër vitet e fundit.

Si të aplikoni?

Për të marrë pjesë në Trajnimin për Trajnerë në temën “Mobilizimi i burimeve të reja financiare dhe jo-financiare për organizatat e shoqërisë civile”, të interesuarit/at duhet të plotësojnë formularin online të aplikimit në: <https://www.surveymonkey.com/r/PYY8TXZ>

Në formular përpos të dhënave që kërkohen duhet të ngarkoni edhe:

- CV-në e detajuar, me fokus në përvojën relevante për temat përkatëse; dhe
- Dëshmi të përvojave të ngjashme (nëse keni).

Formulari i aplikimit mund të plotësohet në gjuhën shqipe ose serbe.

Nëse aplikuesi/aplikuesja përfaqëson OJQ-në përkatëse, rekomandohet që organizata të propozojë jo më shumë se 1 anëtarë/e për pjesëmarrje në trajnim bazuar në përgjegjësitë e tyre brenda organizatës.

Vetëm aplikantët/et që përmbushin kriteret e përcaktuara do të kontaktohen për pjesëmarrje në trajnim, ku do të njoftohen edhe zyrtarisht për detajet logjistike. Në rast të pranimit të shumë aplikacioneve, KCSF do t’u jap përparësi atyre që kanë aplikuar të parët, me theks të veçantë sigurimit të barazisë gjinore dhe atyre që operojnë jashtë Prishtinës.

Afati i fundit për aplikim

13 shtator 2024, ora 11:00.

Informata logjistike

Trajnimi i Trajnerëve në temën “Mobilizimi i burimeve të reja financiare dhe jo-financiare për organizatat e shoqërisë civile” do të mbahet **nga data: 23 deri 25 shtator 2024 në Prishtinë**. Pjesëmarrësve të përzgjedhur do t’u kërkohet të jenë fizikisht të pranishëm gjatë tre ditëve të trajnimit. Shpenzimet e transportit lokal do të mbulohen nga KCSF. Informata më të hollësishme do t’u dërgohen kandidatëve të suksesshëm përmes ftesës pas pranimit të tyre në programin trajnimit.

Informata më të gjëra për programin dhe trajnimin

Programi për Angazhim Qytetar (CEA) në Kosovë është një iniciativë pesë vjeçare zbatuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF) në partneritet me Agjencinë e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID). Është një përkushtim për të kultivuar një kulturë të aktivizmit që e bën jetën nëpër lagjet dhe qytetet tona më të mirë, më të dashur dhe më kuptimplotë. Kjo nismë e imagjionon një të ardhme të ndërtuar në themelet e një shoqërie civile, e

cila përmes aktivizimit të guximshëm, përfaqësimit nga poshtë-lart, bashkëpunimit të gjithanshëm, veprimit profesional, transparencës në të gjitha hallkat e jetës publike dhe institucionale dhe përdorimit ndryshe të burimeve sjell ndryshim rrënjësor në komunitetet tona. Po kështu, kjo nismë e synon një ndjesi të rigjetur të solidaritetit ndaj njëri-tjetrit.

Duke ndërtuar tutje mbi dijen dhe përvojën e fuqishme të zërave më të shquar dhe të udhëheqësve të fushave të mbështetjes profesionale të shoqërisë civile dhe bashkëpunimit institucional, Programi për Angazhim Qytetar është një përkushtim serioz për të shtuar, demokratizuar dhe për të mbrojtur fuqinë që komunitetet tona kanë për të sjellur ndryshim dhe për të përparuar. Përmes përpjekjeve për koordinim të qëndrueshëm, ndërveprim të mirëfilltë dhe përmes përmirësimit të kapaciteteve të atyre që janë përditë të përfshirë në aktivizëm, Programi për Angazhim Qytetar do të çojë përpara një numër të madh veprimesh, që mbështeten në këto tri shtylla qenësore: komuniteti, besimi dhe mobilizimi i burimeve.

Trajnimi për trajnerë në temën e mobilizimit të burimeve të reja financiare dhe jo-financiare për organizata të shoqërisë civile paraqet një nga aktivitetet e shtyllës së tretë të programit ku do të përfitojnë individë që do të përkrahin dhe mentorojnë OShC-të në përgatitje të kampanjave të tyre për ngritje të fondeve.

Duke u bazuar në ekspertizën ekzistuese të KCSF-së dhe organizatës partnere Catalyst Balkans, është zhvilluar një kurrikulë që i përshtatet nevojave të OShC-ve bazuar edhe në vet kontributin e OShC-ve. Pas kryerjes së trajnimit, programi do të ofrojë mentorim, trajnim dhe monitorim të vazhdueshëm për trajnerët në mënyrë që të sigurohet edukim i vazhdueshëm cilësor për mobilizimin e burimeve vendore.

Temat ilustruese që do të trajtohen gjatë trajnimeve janë paraqitur si më poshtë:

- Hartëzimi i aseteve/burimeve të komunitetit;
- Ndërtimi i partneriteteve me donatorët nga komuniteti i biznesit;
- Përdorimi i fushatave dhe ngjarjeve për të mobilizuar burimet e komunitetit;
- Mjete dhe këshilla për mbledhjen e fondeve nga individët;
- Përdorimi i teknologjisë për të angazhuar konstituencën dhe për të mobilizuar burimet.

Pjesëmarrësit e certifikuar në trajnim do të bëhen pjesë e grupit të trajnerëve dhe trajnereve për t'u angazhuar në kuadër të trajnimit të OShC-ve në temën e mobilizimit të resurseve. Angazhimi i tyre do të ketë kompensim financiar.

Informata shtesë

Për informata shtesë ose sqarime të mëtejshme për këtë thirrje, ju lutemi të mos hezitoni të kontaktoni me e-mail tek: enes.toska@kcsfoundation.org ose përmes telefonit në numrin: 038 600 634.